



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:136035

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05425109

**C.nr.183/2016**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.S. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson S.V. avokat nga Prizreni, kundër të paditurit S. (P) V. nga fshati ....., komuna e Prizrenit, tani me banim në R.S. me objekt të padisë vërtetimi i pronësisë, jashtë seancë me datë 07.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore sipas padisë së paditësit D.S. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, kundër të paditurit S. (P) V. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, tani me banim në ..... R.S.
- II.** Procedura e ndërprerë do të vazhdojë sipas propozimit të paditësit, kur ai shpreh interes dhe pushon shkaku i ndërprerjes.

**A r s y e t i m**

Paditësi D.S. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson S.V. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi ndaj të paditurit S. (P) V. nga fshati .... komuna e Prizrenit, tani me banim në ..... R.S. për shkak të vërtetimit të pronësisë.

Gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata ka konstatuar se adresa e të paditurit është në ..... R.S. ndërsa lidhur me komunikimin me autoritetet serbe, deri ditën e këtij aktvendimi janë ndjekur kanalet diplomatike. Nga Ministria e Drejtësisë, si autoritet qendror për procesimin e kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare, është pranuar një përgjigje, datë 02.05.2023, të cilët kanë njoftuar se nga ana e autoriteteve serbe është ndërprerë njëanshëm bashkëpunimi juridik. Gjendur në këtë pozitë, nuk ekziston ndonjë mënyrë tjetër për të vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve procedurale, prandaj në kuptim të nenit 278.1 pika b), gjykata vendosi të ndërprejë procedurën kontestimore. Ndonëse dispozita e cituar i referohet rrethanave që dërgojnë në ndërprerje pa fajin e gjykatës, porse me ngjarje që e bëjnë të

Numri i lëndës: 2019:136035  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05425109

pamundur punën në gjykatë, ndërprerja e komunikimit diplomatik, në një mënyrë është ngjarje jashtë veprimtarisë së gjykatës, e cila bën të pamundur zgjedhjen e ndonjë mënyrë tjetër të komunikimit.

Me ndërprerjen e procedurës, nënkuptohet se për atë lëndë pushon aktiviteti procedural i gjykatës, mirëpo me propozimin e palës aktive në procedurë, mund të vazhdohet e njëjta, në qoftë se parashtron propozim për këtë gjë dhe rasti mund të përfundojë meritorisht.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 278.1 pika b), 387.1 pika e) dhe 142 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.183/2016, datë 07.03.2024**

**Gj y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.